

PIERCAMILLO DAVIGO
SISTEMI I KORRUPSIONIT

BOTIMET TOENA

PIERCAMILLO DAVIGO

SISTEMI I KORRUPSIONIT

Përktheu nga origjinali italisht

Zamir Poda

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2021

Autori: Piercamillo Davigo (Pierkamilo Davigo)

Titulli në origjinal: Il sistema della corruzione

Botoi në italisht: Editori Laterza

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Besa Vila

Korrektore letrare: Majlinda Bami

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-327-97-0

© 2017, Gius. Laterza & Figli

© në shqip Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

www.toena.al

PËRMBAJTJA

HYRJE	7
I. Përse hetimet e tanxhentopolit patën kaq shumë sukses	17
II. Përse u rrëzua një sistem i tërë politik.....	27
III. Restaurimi	41
IV. Serial dhe depërtues: si funksionon korrupsioni	47
V. Kur bizneset ndajnë prokurimet.....	67
VI. Përse lufta kundër korrupsionit ishte jo e duhura	85
VII. Kultura e korrupsionit	121
VIII. Çfarë duhet bërë?.....	127

HYRJE

Në veprimtarinë time, si magjistrat për një periudhë pothuajse 40-vjeçare, më është dashur të merrem gjatë me korrupsionin dhe krimin e organizuar: efektivisht po merrem edhe sot, por tashmë si gjyqtar.

Kam pasur mundësinë të analizoj nga afër dhe për një periudhë të gjatë fakte dhe protagonistë të këtyre dy fushave të ndryshme, por të lidhura ngushtë dhe që, për fat të keq, në Itali më shumë se gjetkë, kanë zënë në mënyrë të vazhdueshme faqet e para të gazetave.

Ndër të tjera, veprat penale të korrupsionit prezantojnë një shifër të errët (ose më saktë diferencën ndërmjet numrit të krimeve të kryera dhe atyre që rezultojnë nga statistikat gjyqësore) shumë të lartë. Për të kuptuar më mirë, numri i dënimeve në Itali për 100 000 banorë, është më i ulët, për shembull, respektivisht me Finlandën (i cilësuar si vendi më pak i korruptuar në botë), ndërsa indeksi i perceptimit të korrupsionit, sipas *Transparency International*, e vendos Italinë prapa shumë vendeve afrikane dhe aziatike. Edhe pse kriminaliteti i padukshëm duket se është më i lartë në zonat e Qendrës dhe të Jugut të vendit, mund të hipotizohet që prania kryesore e krimin të organizuar dhe nënkultura, që përbën burimin e tij ideologjik, pengojnë dukjen e kriminalitetit të lidhur me aktivitetin keqbërës politiko-administrativ. Por mbi këtë moment do të kthehem në faqet që vijojnë.

Kam shprehur shpesh publikisht - në shkrimet e mia dhe gjatë debateve në medie - opinione që më

kanë dalë duke trajtuar procedime, veçanërisht rreth natyrës së korrupsionit: mbi mënyrat e prezantimit të tij, mbi thelbin e paefektshmërisë të sistemit normativ për sa i përket veprimtarisë goditëse dhe mbi mundësitë e adoptimit e miratimit të normave juridike të nevojshme. Në faqet që vijojnë ka një qartësim të unifikuar të të gjitha mendimeve.

Korrupsioni është parashikuar në Kodin tonë penal (italian) në dispozitat e parashikuara në nenet 318-322, ku përcaktohen veprat penale që kryhen nga zyrtarë publikë kundër administratës publike. Në një vështrim të parë, ajo mund të përcaktohet si një pakt i veçantë (*pactum sceleris*) ndërmjet një funksionari publik dhe një subjekti privat, sipas të cilit, i pari pranon nga i dyti, si kompensim për kryerjen e një veprimi relativ, që lidhet me detyrën e tij, një kompensim që nuk i takon. Megjithatë, më tej akoma, do ta shikojmë në terma të një kuptimi më të gjerë, gjithmonë brenda diskutimit në fjalë, duke konsideruar karakteristika themelore të fenomeneve korruptive edhe aktet e mitëmarrjes, trafikut të influencave e financimeve të paligjshme të partive dhe eksponentëve politikë.

Sipas mendimit tim, duke bërë këtë saktësim, dua të nënvizoj një aspekt të rëndësishëm për të kuptuar se çfarë është efektivisht korrupsioni dhe për çfarë motivesh është kaq shumë e vështirë për ta çrrënjësuar. Faktikisht, sikundër do ta shohim, ai prezanton dy karakteristika themelore: është serial dhe depërtues.

Është serial, për sa kohë ata që i janë dedikuar kësaj paligjshmërie, kërkojnë ta kryejnë me vetëdije sa herë u jepet rasti, sipas tyre e arsyeshme, sepse nuk do të dënohen.

Është depërtues, për sa kohë të korruptuarit, korruptuesit dhe sekserët, për të siguruar përfundimisht realizimin e pakteve të paligjshme dhe për të evituar zbulimin e tyre, kërkojnë të implikojnë të tjerë persona, duke krijuar një rrjet të dendur raporti reciprok të paligjshëm, derisa të kenë përjashtuar njerëzit e ndershëm nga mjediset kryesisht korruptive.

Prandaj, do të ishte gabim i rëndë të konsiderohen veprat penale të korrupsionit si episode të izoluara dhe të mos vendosen ato në kontekstin e përgjithshëm ku kryhen. Është ky motivi që “sistemi i korrupsionit” domosdoshmërisht duhet parë në tërësinë e kompleksitetit të tij, përtej fakteve individuale dhe përgjegjësiwe personale. Është një sistem që shpeshherë siguron lidhje me vepra të tjera penale, sikundër janë ato që kanë të bëjnë me çështjet fiskale, pra të falsifikimit të kontabiliteteve, manipulimit të ankandëve apo pastrimit të parave.

Disa shembuj janë domethënës, për të kuptuar se sa këto akte kriminale çojnë në helmimin e një mjedisi të tërë: një i hetuar, në vitin 1992 (në fillimet e hetimit të njohur si Tanxhentopoli), duke folur për një ent të nivelit kombëtar - referonte - se atje vepronte një kartel me rreth dyqind biznese, që shpërndanin kontratat dhe që paguanin praktikisht cilindo brenda entit, përveçse partive kryesore. Për më tepër, sqaronte se ky sistem vepronte prej më shumë se njëzet vjetësh.

Dhe jo vetëm kaq. Sistemi i korrupsionit, për të cilin po flasim, përfshin edhe lidhje të ngushta me krimin e organizuar. Nuk do të ishte e tepërt të kujtojmë se merkato e korrupsionit është një merkato

e paligjshme, në mjedisin e së cilës nuk është e mundur të zbatohet respektimi i rregullave apo i marrëveshjeve të lidhura, duke përdorur forma të mbrojtjes ligjore.

Ja pse “tutela” i besohet presionit të vetë merkatos së paligjshme: nëpërmjet përjashtimit të një biznesi, që nuk ka depozituar një tanxhent të premtuar për kontratat relative që do të vijnë për furnizime malli apo për shërbime; ose përjashtimi i funksionarit publik që, ai vetë apo zyra që ai mbulon, nuk kryen veprimin, për të cilin kishte marrë paratë nga depozitat e ardhshme, nëpërmjet transferimit ose moskandidimit në zgjedhje.

Sidoqoftë, mekanizma të tillë janë efikas vetëm nëse të gjithë aktorët e merkatos së paligjshme e perceptojnë atë të *qëndrueshme* në kohë dhe të *kënaqshme* në funksionimin e saj.¹

Jashtë kësaj hipoteze janë të domosdoshëm edhe rregullatorë të jashtëm dhe më i rëndësishmi është krimi i organizuar.

Kur një merkato e paligjshme menaxhohet nga krimi i organizuar, respektimi i rregullave të tilla është i siguruar nga pushteti i frikshëm që ushtron organizimi kriminal² dhe - ose kur kjo nuk mjafton -

¹ A. Vannucci, “*Ligji*” i tanxhentit. *Strategjia për të luftuar korrupsionin italian, në “Etika e bizneseve dhe profesioneve”, 1995, f. 26.*

² G. Turone, *Krimi i shoqërisë mafioze*, Giuffrè, Milano 1995, f. 99, në të cilin autori insiston që forca e frikës “bën pjesë në pasurinë e sipërmarrjes të shoqërive të tipit mafioz, ashtu sikundër emri i mirë tregtar bën pjesë në sipërmarrje”.

atëherë përdoret forca. Mendoj se këto shënime janë të mjaftueshme për momentin.

Në këtë libër shpresoj të ndaj me lexuesin, në mënyrën më të kuptueshme, të paktën në linjat thelbësore se si funksionon sistemi i korrupsionit, me qëllim që të keni mundësinë të shihni me sytë tuaj lajmet e kronikës, ndryshe dhe me vetëdije të plotë.

Sipas mendimit tim, në njëzet e pesë vitet e fundit, diskutimet rreth korrupsionit kanë qenë, në më të shumtën e rasteve, sipërfaqësore dhe të përgjithshme. Rrallëherë kam pasur vullnetin të thellohem në njohjen e fenomeneve, të studioj dimensionet e tij, apo të vlerësoj dështimet që kanë rezultuar.

Nënvizoj një moment: dëgjohet shpeshherë të përmendet shifra prej gjashtëdhjetë miliardë euro në vit si kosto e korrupsionit, duke ia atribuar këtë vlerësim Gjykatës së Llogarive, institut që kurrë nuk e ka marrë seriozisht një hipotezë të tillë. Në realitet, kjo shifër mbetet hipotezë dhe e paprovuar deri më tani që korrupsioni prek afërsisht 3 % të Produktit të Brendshëm Bruto (Prodotto interno lordo - Pil).

Është e vërtetë që të vlerësosh kostot e korrupsionit është një ndërmarrje vendosmërisht e vështirë. Ndër studimet që lidhen me këtë temë, më duken veçanërisht origjinale ato të Miriam A. Golden¹ dhe

¹ Pedagoge e shkencave politike në Universitetin e Kalifornisë në Los Anxhelos. Ka botuar një sërë punimesh në fushën e korrupsionit si *Corruption, What Everyone Needs to Know, Heroic Defeats: The Politics of Job Loss* etj. (shënim i përkthyesit).

të Lucio Picci-t¹, që e konsideronin koston e punëve publike një matës efikas të korrupsionit.

Dy studiuesit krahasuan shpenzimet e rajoneve italiane në infrastrukturë, në raport me inventarin e asaj që efektivisht u krye në të vërtetë në ato zona. Krahasimi ndërmjet shpenzimeve dhe veprave, realisht të ndërtuara, shërbeu për të përpunuar një indeks të korrupsionit në rajonet italiane, që efektivisht tregoi diferenca të dukshme. Po ashtu rezultoi se rajonet e jugut edhe pse shpenzonin mesatarisht më shumë se rajonet veriore për të pasur infrastrukturë, në të kundërt, këtë e kishin më të paktë. Kjo diferencë tregonte koston, agregatin e korrupsionit dhe joefikasitetin.

Më duket se diskutime të tilla të ngjashme - që do të ofronin bazë të fortë për argumentin - janë sjellë shumë rrallë në debatet publike.

Për më tepër, po të kërkojmë me kujdes, disponohen lehtësisht burime - edhe me data - që ilustrojnë natyrën e fenomenit të korrupsionit, raportet ndërmjet korrupsionit dhe sistemit politik, si dhe ndërmjet korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Kështu, në relacionin e miratuar në 25 korrik 1990, mbi rezultatet e hetimeve të Grupit të punës të Komisionit parlamentar, për hetimet mbi fenomenin e mafies, krijuar me Ligjin 94/1988, ndër të tjera

¹ Lucio Picci, Profesor i Politikës ekonomike në Universitetin e studimeve të Bolonjës. Merret kryesisht me temat e krahasimit të inovacionit dhe shkencave politike. Ka botuar studime në këto fusha si dhe një numër kontributesh veçanërisht dedikuar fushës së korrupsionit (shënim i përkthyesit).

lexohet se grupet mafioze kërkojnë me çdo mënyrë të krijojnë lidhje me pushtetin politik.¹

Për bashkëpunimin ndërmjet kriminalitetit mafioz dhe korrupsionit të funksionarëve publikë, aludohej edhe më parë te rezultatet e komisioneve parlamentare të hetimit ku disa herë, që nga fundi i viteve '50, janë bërë propozime të ndryshme, pikërisht sepse dyshohej në lidhjet domethënëse të mafies dhe prokurimeve publike.

Por, megjithatë, duhet të kujtohet - ashtu sikundër mendonte edhe Alberto Vannucci - se "ajo mafiozja dhe ajo e korrupsionit janë *industri* që merren me mallra të veçanta: mbrojtje private në një rast, të drejta pronësie mbi përfitimet politike në një rast tjetër. Nga ana tjetër, në përgjithësi shërbimet e furnizuara nga secila prej dy *industrive* janë të dobishme për aktivitetin e tjetrës, ose përdoren nga sipërmarrës, fajdexhinj, mafiozë, politikanë. Akordet e korrupsionit dhe shkëmbimet politike e elektorale janë forcuar nga tutela mafioze, që garanton në të njëjtën kohë heshtjen. Kështu, në mënyrë domethënëse, pohimet e provuara e të ballafaquara të të korruptuarve dhe të korruptuesve kanë dhënë për hetimin 'Duart e pastra' një forcë të madhe shtytëse për pjesën tjetër të Italisë, por dhe kanë shënjuar një hap të rëndësishëm goditës në mjediset më të larta të përqendrimit mafioz"².

¹ Një fragment i relacionit është sjellë nga N. Tranfaglia, *Mafia, politika dhe bizneset. 1943-91*, Laterza, Roma-Bari 1992, f. 368.

² A. Vannucci, *Merkatoja e korrupsionit. Mekanizmat e shkëmbimit të fshehtë në Itali*, Shoqëri e hapur, Milano 1997, f. 178.

Këto tematika, për kërkime dhe njohje rreth problemeve, që thuhet se duhen përballuar, rrallëherë janë ritrajtuar në debatet publike dhe në veprimtaritë përgatitore të ligjeve; më duhet të shtoj se, përkundrazi, për vite me radhë nismat politike kanë qenë të një drejtimi të kundërt me atë që do të duhet të ishte e nevojshme të bëhej. Si pasojë, linjat mbajtëse të fenomeneve korruptive dhe të raporteve ndërmjet korrupsionit dhe krimit të organizuar kanë mbetur thelbësisht të pandryshuara në dyzet vitet e fundit.

Por a ka ndryshuar gjë? Nuk do ta thosha: janë të larmishme mënyrat konkrete të prezantimit të këtyre fenomeneve dhe të teknikave të përdorura.

Në vitet '80-'90 të shekullit të kaluar, për sa i përket korrupsionit politik, ishte një sistem i centralizuar, me depozitime të fshehta për sekretaritë e partive politike të ndryshme, thelbësisht të përcaktuara respektivisht me prokurimet e veprave të mëdha publike. Ndërkaq, bëhej fjalë për pak subjekte që përfitonin shuma të mëdha.

Krahas me këtë sistem të centralizuar (ose në ndonjë rast edhe brenda tij), ishte edhe një sistem i decentralizuar i korrupsionit, që implikonte një numër subjektesh me tanxhente në sasi më të vogla.

Paralelisht me korrupsionin politik, ishte pastaj një zonë jo e vogël e korrupsionit burokratik.

Duke bërë një krahasim ndërmjet korrupsionit në kohët e Tanxhentopolit dhe asaj që efektivisht ndodh sot, do të thosha që zona e parë (ajo e korrupsionit politik të centralizuar) duket se ka pësuar goditje të rënda, ndërsa e dyta dhe e treta (ajo e korrupsionit politik të decentralizuar dhe e korrupsionit burokratik),

duken se e kanë kaluar me lehtësi veprimtarinë goditëse të hetimit dhe gjykimit.

Por si do të shohim, regjistrohen ndryshime të tjera. Për shembull, janë modifikuar mënyrat korruptive: dorëzimi i parave në dorë është zëvendësuar (në shumë raste) edhe me një formë tjetër shpërblimi (nëpërmjet emërimeve, konsulencave etj.).

Më tej, janë rritur pagesat jashtë për të huaj¹ - veçanërisht në parajsat e shoqërive bankare ose fiskale - që kanë vështirësi për t'u identifikuar në kohë të shpejtë.

Në një botë, në të cilën kufijtë janë kthyer në të kalueshëm dhe ku sistemet informatike e telematike lejojnë të kalosh shuma të mëdha nga një vend në tjetrin në pak sekonda, procedurat e ndihmës juridike ndërkombëtare vazhdojnë të jenë çuditërisht mjaft të ngadalta dhe ndeshja ndërmjet rojave e vjedhësve - e trishtueshme të thuhet - është e zhbalancuar në favor të vjedhësve.

Për fat të keq, edhe ndërhyrjet e natyrës parandaluese, të parashikuara nga legjislacioni, nisur nga viti 2012 (i referohem të ashtuquajturit ligji Severino), nuk duket të jenë efektive, duke u kufizuar në traditën italiane të burokracisë mbyttëse dhe të kontrolleve formale joefektive.

Pothuajse mungon kontrolli i produkteve si: me çfarë mallra apo shërbime është furnizuar Administrata Publike, me çfarë çmimi, për sa kohë dhe me çfarë

¹ Nënkupto në emër të personave të caktuar nga i korruptuari (shënim i përkthyesit).

cilësie. E megjithatë, të dhënat për kostot e punëve publike në Itali dhe afatet e tyre të realizimit, që në përgjithësi janë dyfishi respektivisht me ato të vendeve të tjera të huaja, duhet të tërheqin vëmendjen.

Uroj që ky libër të krijojë një stimul për reflektim.

Falënderime

Dëshiroj të falënderoj Shtëpinë Botuese që më propozoi të shkruaja këtë libër, duke më mbështetur me profesionalizmin e lartë të saj.

Një falënderim i veçantë për Lia Di Trapani-n, që më ka ndihmuar me inteligjencë, durim dhe kompetencë, për më tepër duke më siguruar se ishte vërtet e kënaqur.

I

Përse hetimet e tanxhentopolit patën kaq shumë sukses

Kanë kaluar njëzet e pesë vjet kur në 17 shkurt 1992, në Milano, u arrestua Mario Kieza¹, domethënë nga ajo që u konsiderua si fillimi i hetimeve dhe që mjetet e informacionit në masë e kanë quajtur “Duart e pastra”. Nuk ishte, kjo, hera e parë që një administrator publik do të kapej në flagrancë për korrupsion dhe nuk ishte e fundit. Por, atëherë, cila ishte arsyeja që pas kaq shumë kohe, e kujtojmë akoma këtë episod?

Besoj se shpjegimi duhet kërkuar në zhvillimin surprizë të hetimeve për këtë ngjarje, që në një kohë relativisht të shpejtë (veçanërisht nëse krahasohet me kohën që merr veprimtaria hetimore e gjyqësore) çoi në zbulimin e një numri të pabesueshëm krimesh dhe implikimin e mijëra politikanëve, funksionarëve

¹ Mario Chiesa, më 17 shkurt 1992, ndërsa mbulonte detyrën e Presidentit të Pio Albergo Trivulzio - ent publik për kujdesin e të moshuarve, kapet në flagrancë ndërsa pranonte një tanxhent prej shtatë milionë lireta italiane nga biznesmeni Luca Magni, i cili administronte një shoqëri të vogël pastrimi dhe që donte të sigurohej për t’u shpallur fitues në prokurimin për pastrimin e azileve (shënim i përkthyesit).

dhe biznesmenëve. Dëshiroj të them, se të parët që u befasuam ishim pikërisht ne hetuesit.

Çfarë kishte bërë diferencën në këto hetime, respektivisht me të tjera të mëparshme apo të mëpasshme? Në këto vite, meqë ra fjala, janë dëgjuar nga ana e komentatorëve të ndryshëm, një numër i madh marrëzrash: “këtë e dinin të gjithë”, “ku ishte deri tani magjistratura?”, “ishte një grusht shteti” (orkestruar nga komunistët, nga CIA, nga pushtete të forta etj.). Edhe marrëzira të tjera, që nuk ia vlen të kujtohen.

Para së gjithash, nuk është e vërtetë që “e dinin të gjithë”. As kolegët e mi dhe as unë, pavarësisht se e perceptonim që krimet e gjobave, të korrupsionit, të financimit të paligjshëm të partive politike dhe të komunikimit social fals, ishin në numër më të madh nga sa rezultonte në statistikat gjyqësore, por nuk e imagjinonim këtë dimension të paligjshmërisë, që efektivisht rezultoi më pas.

As qytetarët nuk e imagjinonin që korrupsioni të kishte arritur dimensione të tilla dhe, mbi të gjitha, që përfaqësuesit e partive, edhe opozitare, ndanin tanxhente; prandaj mbetëm të habitur kur në 29 prill 1993, deputeti Betino Kraksi, në Dhomën e deputetëve, foli për një sistem të financimit të paligjshëm për politikën, që i implikonte të gjithë. Ndër deputetët prezentë në sallë natyrisht që kishte edhe të ndershëm që, pa dyshim, nuk e dinin se çfarë kishte ndodhur brenda partisë së tyre. E megjithatë, atë ditë, askush nuk u ngrit për të thënë se ishte jashtë kësaj meseleje, si dhe të shprehte indinjatën e tij, se

nuk mund të ishte pjesë e hajdutit të përgjithshëm duke ia kthyer Kraksit: “por si guxon ti?”.

E them këtë, jo sepse unë mendoj se ishin të gjithë hajdutë, por sepse asnjëri prej tyre nuk e dinte saktësisht se çfarë kishte ndodhur brenda partisë së tij. E pra kjo është mohim i demokracisë, që përkundrazi kërkon transparencë, njohje të mekanizmave të funksionimit, kontroll. “Accountability”, do të thoshin anglosaksonët, por nga ne duket si “nuk jemi asgjë çfarë duhet të jemi”. Dhe kam shumë dyshime mbi faktin se nën këtë aspekt diçka ka ndryshuar në vitet e fundit.

Sidoqoftë, mbi motivet që çuan në zbulimin e ndodhive të tilla dhe të evidentuara në këtë moment, disa reflektime janë domosdoshmërisht oportune.

Para së gjithash duhet kujtuar (edhe pse duket e njëjta gjë) që gjuetia dhe kapja e presë, janë dy gjëra të ndryshme. Mund të shkosh për gjueti duke ndjekur në perfeksion rregullat e saj dhe të mos kapësh asgjë, ashtu sikundër mund të jesh gjuetar i dobët e megjithatë të kesh fat, duke u kthyer si me shaka me një gjah të pasur. Në të njëjtën mënyrë, hetuesit mund të kryejnë hetime në mënyrat më të mira dhe të mos përftojnë asnjë rezultat.

Duke thënë këtë, mendoj se janë identifikuar disa faktorë specifikë, që mund të kontribuojnë për të shpjeguar rezultatet, veçanërisht favorizuese, që sollën ato hetime të kryera në periudhën nga viti 1992 e deri në vitin 1995.

Debiti tepër i madh publik, që vendi ynë kishte akumuluar deri në atë moment, dhe kriza ekonomike

e vitit 1992, ndër të tjera, do të kishin si efekt reduktimin e shpenzimeve publike për të blerë mallra dhe shërbime. Për rrjedhim, ishte zvogëluar mundësia për të korrptuarit që të transferonin kostot e tanxhenteve në bilancin e administratës publike dhe ndërkohe të shpresonin në prokurimet e ardhshme fitimprurëse. Është bindja ime e vendosur, dhe këtë e kam përsëritur disa herë, që hetimet përfundohen me rezultat pozitiv veçanërisht në momentet e recesioneve të rënda ekonomike.

Për të sqaruar për sa u tha, është e dobishme të kujtohen, si shembuj, tri skandalet e mëdha: mashtrimet me naftën në vitin 1974¹; çështja e P2² e

¹ Ishte një çështje politiko-financiare. Në 13 shkurt 1974, sekretarët administrativë të partive, atëkohë në pushtet, u hetuan nga magjistratura e Gjenovës sepse kishin marrë fonde nga ENEL, kompani elektrike shtetërore dhe nga kompani të naftës, për një politikë energjetike kundër centraleve bërthamore. Sipas gjykatës, tanxhentet ishin 5 % mbi avantazhet që derivonin për kompanitë e naftës nga miratimi i disa ligjeve. Pra ishin përfitime nga efektet e masave legjislative dhe jo thjesht nga kontratat, apo nga furnizime. Sa më sipër solli dorëheqjen e qeverisë të kryesuar nga demokristiani, Mariano Rumor, më 2 mars 1974 (shënim i përkthyesit).

² *Propaganda dy*, Lozhë masonike e devijuar, e rikrijuar nga Liçio Xheli, dënuar për pengim të hetimeve mbi masakrën e Bolonjës dhe *trait d'union* të mijëra aferave të ndyra të Republikës së Parë, mbetur gjithnjë i pushtetshëm edhe pse i dënuar. Janë vërtetuar lidhje të saj me krimin e organizuar. Është shpërndarë në janarin e vitit 1982. Për të, Sandro Pertini, atëkohë president i republikës italiane, ka thënë: “Askush nuk mund të mohojë që P2 është një organizatë kriminale” (shënim i përkthyesit).

në vijim në vitin 1981 çështja e Bankës Ambroziane¹; dhe më në fund - pikërisht - “Duart e pastra” në vitin 1992.

Bëhet fjalë për tri raste shpërthyese, të gjitha të lidhura me kriza të rënda ekonomike, me rënien e prodhimit të përgjithshëm bruto dhe, mbi të gjitha, me zvogëlimin e shpenzimeve të administratës publike për blerjen e mallrash dhe shërbimesh.

Dhe kush është shpjegimi i mundshëm?

Janë dy motive për t’u marrë në konsideratë. I pari është ai i përfundimit të lajmeve për krimin. Kufizohem në këtë rast për korrupsionin, edhe sepse krime të tjera kanë të bëjnë me fakte të ndryshme nga korrupsioni, të cilat në përgjithësi nuk i janë bërë të ditura autoritetit gjyqësor. Korrupsioni nuk bëhet para dëshmitarëve dhe është i njohur vetëm për ata që përfshihen në të, domethënë për të korruptuarit dhe korruptuesit që kanë interesa të përbashkëta dhe ndajnë të njëjtin

¹ Ishte nga bankat kryesore private katolike italiane. Krijuar në vitin 1896 dhe falimentuar në vitin 1982, vlerësuar në 1, 2 miliardë dollarë, nën presidencën e Roberto Calvit, anëtar i Lozhës masonike P2. Ashtu sikundër thotë Paolo Borsellino, i rekomanduar nga majat e Shtetit, i futur në sferën e financave ndërkombëtare dhe i ngarkuar për të administruar në të njëjtën kohë miliardat e tanxhenteve të destinuar për njerëzit dhe partitë politike, si dhe për kapitalet e mafies, duke përdorur të njëjtët kanale, ndër të cilët IOR - Banka e Vatikanit. Kapitalet mafioze, më pas në bashkëpunim edhe me Lozhën masonike P2, do të investoheshin për blerjen dhe pjesëmarrjen në disa grupe të rëndësishme sipërmarrjesh (shënim i përkthyesit).

synim, të ruajnë heshtjen. Dhe efektivisht zbulohet kur janë duke u kryer hetime për vepra të tjera penale, apo dhe kontrole administrative. Dhe, mbi të gjitha, zbulohen kur thyhet pakti i solidaritetit ndërmjet atyre që kryejnë krime, domethënë kur ndërmjet tyre ka grindje e mosmarrëveshje. Kjo ndodh, zakonisht, kur “torta” nuk po rritet më, përkundrazi po zvogëlohet, domethënë kur shpenzimet për blerjen e mallrave, aseteve dhe shërbimeve, zvogëlohen, kështu që një shumë e caktuar parash nuk mund të përdoret, shumë e cila do të duhet të jetë gjithnjë e më e madhe çdo vit për të kënaqur ata që futen rishtas, si dhe për të zgjidhur mosmarrëveshjet apo grindjet. Pikërisht në këto situata, shpërthejnë mosmarrëveshjet: ky është momenti kur hetuesit arrijnë të futen dhe, më në fund, të marrin të dhëna për krimin.

Arsyeja e dytë është, që në momente të rënies ekonomike, opinioni publik është pak i gatshëm - e thënë kështu - të pranojë t’i tregohen gënjeshtër. Për shembull, tërbohen kur dëgjojnë të thuhet se disa personazhe të fuqishme, që janë përndjekur nga magjistratë të çmendur, pavarësisht kësaj, do të kalojnë në funksione të tjera të pushtetit, apo se po kurdiset një komplot medie-gjyqësor për të rrëzuar klasën drejtuese në pushtet.

Në kushte normale - për ta kuptuar, kur nivelet e papunësisë dhe problemet sociale janë nën kontroll (dhe më mirë akoma nëse kemi një kampionat futbollit në zhvillim e sipër!) - është e mundur që shumica

e njerëzve nuk është e gatshme për këto gjëra dhe, nuk them që e pranojnë, por akoma më pak, nuk indinjohen. Anasjelltas, sa më shumë nuk ia arrijnë të shtynjë fundin e muajit, aq më shumë inatosen për çfarë flitet e dëgjohet, dhe kështu besohet se pjesa më e madhe e gjërave të kundërshtuara janë të vërteta.

Në sintezë, krizat ekonomike, nga njëra anë duket se shkaktojnë një reagim më të madh të opinionit publik ndaj tentativave për të mbuluar ngjarjet e korrupsionit dhe nga ana tjetër, përcaktojnë një ulje të shpenzimeve, nxjerrin në pah kriza dhe kontradikta në sipërmarrjet që kanë administratën Publike si klient ekskluziv, apo të parapëlqyer. Kjo, ka tendencë të gjenerojë kontraste, që çojnë në qëndrime bashkëpunuese me autoritetet e hetimit ose, sidoqoftë, parandalojnë marrëveshje se çfarë gjërash do të duhet të mbahen të fshehura. Gjithashtu, një krizë ekonomike prodhon një rritje të deklarimeve të falimentimit, që për rrjedhojë pason me nisjen e procedimeve penale për krime të falimentit: një gjë e tillë, zakonisht, çon në zbulimin e falsifikimit të kontabiliteteve e për rrjedhojë, nëpërmjet individualizimit të destinacionit të fondeve të menaxhuara jashtë bilancit zyrtar, në hedhjen dritë për krime të korrupsionit.

Ja sepse fazat negative të ciklit ekonomik, janë ato ku për autoritetet e kontroll-revizionit e më tej edhe për magistraturën, rezultojnë më pak problematike për ndjekjen me sukses të madh të objektivave institucionale, si për parandalimin e qëndrimeve

jokonkurrese, ashtu edhe për goditjen e fenomeneve të korrupsionit.

Natyrisht, kur situata e përgjithshme përmirësohet ndodhin ngjarje të reja, që është pak të thuhet shqetësuese. Kështu po përmend një rast; senatori Karlo Xhovanardi¹, ka shkruar disa vite më parë një libër, ku mbronte një tezë me të vërtetë argëtuese. E kishte fjalën, se i ashtuquajtimi “Parlament i të akuzuarve”, ai që në historinë e Republikës kishte pasur numrin më të madh të parlamentarëve të vendosur nën procedim penal, ishte në realitet një Parlament i të përndjekurve dhe, në mbështetje të kësaj teze të tij, kujtonte që, më pas, pothuajse të gjithë kishin marrë pafajësinë apo ishin pushuar hetimet. Përveç faktit se, për shumë nga këta parlamentarë, nuk ishin pushuar hetimet në kuptimin e plotë, sepse thjesht një pjesë e akuzave ishin parashkruar, gjë që ishte një gjë krejt tjetër (dhe presim që një parlamentar të dijë mirë diferencën rreth pushimit të akuzës se nuk është kryer apo se nuk ka vepër penale, dhe pushimit për parashkrim!), problemi qëndronte në atë, se pjesa më e madhe e këtyre pushimeve të hetimeve apo gjykimeve, u bë e mundur për shkak se ndërkohë pati një ndryshim të legjislacionit!

Sa më sipër, këto ngjarje mund të shihen gjithmonë në dy mënyra, madje të kundërta: kur një person i

¹ Carlo Giovanardi, ish-deputet i Partisë “Populli i Lirisë”, senator dhe ministër i Raporteve me Parlamentin në qeverinë Berlusconi (shënim i përkthyesit).

arrestuar lirohet nga akuzat, mund të flitet për “pranga të lehta”, apo (sikundër thoshte gjenerali Dala Kieza¹) për “padrejtësi që liron”. Është po ajo pyetje, e gotës gjysmë plot ose gjysmë bosh: nevojitet të shihet, nëse është i drejtë interpretimi i parë, apo ai i dytë.

¹ Carlo Alberto Dalla Chiesa, gjeneral i karabinierisë italiane. Njeriu që udhëhoqi më parë luftën kundër banditizmit dhe më pas atë të “Brigadave të kuqe”. Në vitin 1982 u emërua Prefekt i Palermos, me synimin për të luftuar mafien. U vra nga mafia më 3 shtator 1982, njëqind ditë pasi mori detyrën, së bashku me bashkëshorten Emanuela Setti Carraro dhe truprojnë Domenico Russo. (shënim i përkthyesit)

II

Përse u rrëzua një sistem i tërë politik

Në vitin 1992, me fundosjen e ideologjive, hyri në krizë edhe tradicionalja *formë - parti*, si instrument i tërheqjes së konsensusit dhe marrëse e besnikërisë absolute të anëtarëve. Më kujtohet që, në një transmetim televiziv, pak kohë mbas arrestimit të një eksponenti të rëndësishëm lokal të PDS-së¹, një anëtar i asaj partie komentoi faktin, duke thënë se, prej tridhjetë vjetësh shkonte në festën e UNITA-s² si vullnetar për të gatuar salsiçe dhe tani që mësoi se, ndërsa rrotullonte salsiçet në skarë, shefat e tij vidhnin, e mbylli duke pohuar se ata do të duhej të përfundonin në burg.

Shkaqet e sipërcituara (recesioni, fundosja e ideologjive, krizat tradicionale *formë - parti*) lejuan zbulimin e një kompleti të gjerë të korrupsionit dhe

¹ Partia Demokratike e Majtë (shënim i përkthyesit).

² Është emri i festivalit vjetor Social-Demokrat në shumë komuna të Italisë i filluar nga Partia Komuniste nga 1945 deri 1991 dhe vazhdon nga Partia Demokratike nga 2007.

Kanë organizuar këtë festival dhe Partia Demokratike e Majtë nga 1992 deri 1997, Demokratët e Majtë nga 1998 deri 2007 (shënim i përkthyesit).

reagimi i opinionit publik - ndjeshmëria e tij, ashtu sikundër e kam thënë, ishte përkeqësuar nga krizat ekonomike - pati efekte (në dukje) përçarëse në panoramën politike: do të dilnin nga skena pesë parti, ajo e maxhorancës relative (Demokracia Kristiane) dhe katër të tjera (Partia Socialiste italiane, Partia Socialdemokrate italiane, Partia Republikane italiane dhe Partia Liberale italiane), tri nga të cilat kishin më shumë se njëqind vjet. Një tërmet i vërtetë.

Faktikisht, për sa i përket politikës, gjërat shkuan gjithnjë e më keq respektivisht me sipërmarrjet dhe bizneset. Kjo, sepse ekzistonte rreziku serioz që kush vidhte më shumë bënte karrierë. Më kujtohen dy raste. I pari i përket Mario Kiezës, që sikundër ka shpjeguar, me lekët e tanxhenteve mbante të hapur në Milano një seksion të Partisë Socialiste italiane, për të cilën paguante gjithçka, përfshirë taserat e anëtarëve, por që asnjeri prej tyre nuk e dinte se ishte i anëtarësuar. Kishte nga ata që sollën *klauzolën* e pensionistëve, që i duartrokisnin në manifestimet e partisë. Dhe për këtë, u organizuan udhëtime sociale me pensionistët, të cilët konsideroheshin anëtarë, por që nuk ishin të ndërgjegjshëm aq sa paraqiteshin, si të thuash ata ekspozoheshin si të tillë.

Dhjetë vjet pas Mario Kiezës, u arrestua drejtori i përgjithshëm i Spitalit Molinete të Torinos¹,

¹ Shërbimi spitalor universitar San Giovanni Battista, një strukturë spitalore publike, ndër më të mëdhatë në Piemont dhe më gjerë në Itali (shënim i përkthyesit).

i cili shpjegoi se me tanxhentet, blinte çdo vit tetëqind tesera të partisë së tij, sepse dëshironte të bëhej këshilltar rajonal për Shëndetësinë dhe, në perspektivë, zëvendësministër për Shëndetësinë në qeverinë kombëtare.

Ngjitja në karrierën politike bëhet duke ecur normalisht me meritë dhe kur një gjë e tillë shpesh nuk bëhet, ja se si investohet për të. Por problemi është se një politikan për së mbari, për të marrë pozicione në parti, duhet të bindi anëtarësinë e vërtetë që të votojnë për të; në të kundërt, një maskara investon anëtarësinë që nuk ekziston, me rezultate që gjithmonë sjellin për rrjedhojë mundjen e politikanit të ndershëm, sepse nëse këta bindin një mijë zgjedhës, i pandershmi krijon një mijë e njëqind tesera dhe sidoqoftë fiton. Nuk jam në gjendje të flas për sa ndodh ekzaktësisht sot, sepse akoma nuk e njoh mirë sistemin primar.

Personalisht, nuk jam dakord me analizat, sipas të cilave, një nga shkaqet vendimtare të suksesit të hetimeve të vitit 1992, do të ishte politika ndërkombëtare dhe në veçanti *aseti i ri* që derivonte nga rënia e Murit të Berlinit. Një tezë e tillë, mbështetet në konsideratën që vijon: do të kishte më pak korrupsion, nëse do të kishte alternativë; dhe në Itali, jo se alternativa nuk ishte e mundur për shkak të një situatë ndërkombëtare vendimtare. Supozimi do të ishte i vërtetë, megjithatë efikasiteti i tij shkakësor mohohet nga fakti që, në selitë lokale, alternativa ishte, por që vidhej nga vetë dora e saj.

Tragjedia italiane nuk rezulton nga fakti se në vendin tonë janë të korruptuarit, sepse ata janë

të pranishëm kudo, por nga fakti që maxhoranca dhe opozita i ndajnë ryshfetet. Ky është problemi: sillen si “hajdutët e Pizës”, që do të thotë, se gjatë ditës bëjnë sikur grinden dhe gjatë natës vjedhin së bashku. Më kujtohet çudia ime, kur duke marrë në pyetje sekretarin rajonal të një partie, që natën, në një garazh, kishte marrë në dorë 150 milionë lireta nga një këshilltar rajonal i një tjetër partie, dëgjova të përgjigjej, se bëhej fjalë vetëm dhe thjesht për një financim të paligjshëm. Ndërkohë dyshues, e pyeta: “Dhe përse një anëtar i një partie do të duhej të financonte një tjetër parti? Nëse i pëlqente kjo partia tjetër, përse nuk anëtarësohej tek ajo?” Ai më pa dhe u përgjigj: “Ju nuk kuptoni asgjë nga politika”. Natyrisht, nuk kuptoj asgjë nga *kjo* politikë, sepse mendoj që politika do të duhet të funksionojë sipas rregullave të tjera.

Unë nuk besoj që mund të shpresohet në një bashkëpunim nga ana e politikës, përderisa rregullat e seleksionimit të personelit politik do të mbeten këto aktualet. Po shpjegohem më mirë. Për vite është treguar historia që tanxhettet ishin “kosto e demokracisë”. Kujtoj një person politik që, sipas një bashkëpunëtoreje të tij, kalonte gjithë natën me dy gra dhe, nëse mungonte njëra prej tyre, ajo (bashkëpunëtorja) do të duhet ta zëvendësonte. Dhe e gjithë kjo kryhej, në pjesën më të madhe, me përdorimin e parave që vinin nga episode korrupsioni. E pra, të më falni, këtë njeri mund ta kishin zili shumë të tjerë, por e gjej shumë të vështirë për ta quajtur gjithë këtë, “kosto të demokracisë”.

Në çdo rast, përtej fakteve të keqveprimit individual, është gjithmonë një problem tepër serioz: me tanxhentet nuk është se financohen tërësisht partitë. Kjo është një legjendë, sepse vetëm një pjesë shumë e vogël e tanxhenteve përfundon në arkat e partive: pjesa kryesore, përtej vjedhjeve individuale, shkon për lidhjet e partisë, domethënë për rrymat e saj.

Provojmë atëherë të shikojmë si funksionon konkretisht, përtej rregullave abstrakte, sistemi i seleksionimit të klasës drejtuese në vendin tonë. Ne jemi mësuar të besojmë - duke gabuar - që të zgjedhurit janë zgjedhur nga elektorati: nuk është kështu, ose është vetëm në pjesën minimale. Të zgjedhurit janë zgjedhur nga ai që ndërton listën elektorale, sepse duke kandiduar një person në një zonë të sigurt, ai zgjidhet, ndërsa duke e kandiduar në një zonë jo të sigurt, ai nuk zgjidhet. Në të vërtetë, zgjedhjet mund të varen nga mënyra e vendosjes në lista. Kush i harton listat zgjedhore? Përveç rastit të listave të pavarura, listat zgjedhore hartohen nga ai që ka kontrollin e partisë sepse ka fituar kongresin. Por kush e fiton kongresin? E fiton ai që ka numrin më të madh të votave kongresore që, për më tepër, janë shprehur nëpërmjet delegimeve. Sikundër e kam thënë, problemi real është se një pjesë e konsiderueshme e anëtarësisë nuk ekziston dhe se taserat janë paguar me tanxhente.

Le të japim një tjetër shembull. Një i pandehur, atëkohë zëvendës-president i SEA-s, shoqëri që

menaxhonte aeroportet e Milanos, më shpjegonte, se me paratë e tanxhenteve paguante tesorat e seksionit të partisë së tij. Më pas filloi të flasë për një tjetër subjekt, të cilit i kishte dhënë një pjesë të parave dhe më thotë: “Shiko, një maskara i vërtetë: regjistroi në tesera qindra persona, të gjithë të një pallati” dhe kur unë ia ktheva: “Por më fal, sapo më the që këtë gjë e bëje edhe ti”, ai m’u përgjigj: “Po, po, por ky regjistroi edhe të tesoruar të partisë sime, të duket gjë e bukur kjo? Më vodhi listat”.

E gjithë kjo mund të ndodhë, sepse në Itali partitë politike janë shoqëri jo të njohura, domethënë nuk kanë asnjë rregull, madje as rregullat më minimale që vlejné për një shoqëri personash, edhe për një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Kemi pasur dy sekretarë partish, që kanë përjashtuar maxhorancën e të regjistruarve: të mbetur në minorancë, ata kanë menduar të dëbojnë maxhorancën. Nëse kjo do të ndodhte në një klub bulingu, ortakët do të nxitonin te Kryetari i Bashkisë, për të kërkuar trajtim të detyrueshëm shëndetësor për presidentin që kishte vendosur të dëbonte maxhorancën. Te partitë, përkundrazi, kjo ka ndodhur dhe askush nuk ka bërë zë.

Çështja e parë është që do të nevojitej futja e një rregullimi juridik për jetën e partive, të cilat, ndër të tjera, duke përfutuar burime të mëdha nga shteti, duhet të japin llogari për mënyrën e përdorimit të tyre; ndërkohë që deri tani bilancet financiare janë thjesht të shpikura dhe nuk ka një kontroll efektiv.

Në një kontekst të tillë, me natyrë të korrupsionit të përhapur, prodhohet një mekanizëm pervers, sepse pushteti është në vazhdimësi i këmbyeshëm me paratë nëpërmjet korrupsionit. Krijohet një situatë, në të cilën unë vjedh; duke vjedhur, blej tesera partie, duke blerë tesera kam peshën më të madhe brenda partisë, bëj të zgjidhen besnikët e mi ose megjithatë, bëj të emërohen në shoqëritë ose entet nga të cilat vijnë para të tjera tanxhentesh; pra kemi një qark pervers, ku personat për së mbari llogariten gjithnjë e më pak dhe maskarenjtë gjithnjë e më shumë.

E vetmja mundësi serioze është që opinioni publik të lirohet nga një sistem i tillë, sepse derisa ky sistem do të seleksionojë një klasë drejtuese mbi bazën e këtyre rregullave, është e dukshme që nuk do të mund të jetë në ndihmë të aparateve goditëse (polici, prokurori, gjykatë, kontroll revizioni etj.). Dhe një sistem i tillë do të na mungonte: sepse kurrë nuk do të bënin *vetëvrasje*! Disa herë ndodh, por vetëm kur opinioni publik indinjohet. I ashtuquajtimi “Parlament i të akuzuarve” hoqi autorizimin për të proceduar. Nuk është se parlamentarët u shndërruan kështu papritmas në të mirë; thjesht opinioni publik ishte i tërbuar: donte një sinjal. Dhe atëherë ata, që e dinin mirë se si pasojë e këtij votimi do të përfundonin nën proces, e kuptuan që për të qetësuar në njëfarë mënyre opinionin publik, nevojitej të jepej një sinjal dhe efektivisht bënë diçka. Në të njëjtën mënyrë, në vitet e mëpasshme, u ndërморën disa masa “antikastë”: për shembull, kur u zbulua që disa

komunitete malore kishin arritur në nivelin e detit, u shpërndanë pulla pjesëmarrjeje dhe kompensim për të gjithë, ose një aktivitet i shërbimit publik, i cili më parë ishte kryer nga një kompani, tashmë iu besua në të njëjtën mënyrë tridhjetë e dy kompanive, me të tjera këshilla administrative, kompensimi i të cilave ishte në ngarkim të kontribuuesve.

Problemi është se në vendin tonë kostoja e politikës, e konsideruar në kompleksitetin e saj, është e tepruar: janë shumë persona që jetojnë me politikë, ashtu sikundër janë shumë persona që jetojnë me të tjera aktivitete jo menjëherë produktive (dhe dua të fus në këtë listë edhe drejtësinë), krahasuar me nivelin dhe stabilitetin e ekonomisë.

Për të kuptuar se si e gjithë kjo mund të ndodhë, duhet të provojmë të përshkruajmë fenomenet, duke i konsideruar jo vetëm si raste të veçanta, por edhe në mënyrë globale. Le të marrin disa shembuj nga Milanoja, si atë të metropolitane (por që mund të përsëritet edhe në sektorë të tjerë): sipërmarrjet bashkohen në shoqëri të përkohshme biznesi ose në konsorciume, marrin pjesë në prokurime që më pas i fitojnë dhe sipërmarrësja kryesore, e ashtuquajtura shefe e grupit, mbasi mbledh paratë nga të gjitha bizneset e bashkuara, i depoziton për një politikan, i cili i ndan ndërmjet të gjitha partive të maxhorancës dhe të opozitës. Rezultati i parë është që këto biznese, në njëfarë mënyre, evitojnë konkurrencën e bizneseve të tjera, të cilat nuk bëjnë pjesë brenda mekanizmit

të tutelës. Rezultati i dytë është, se partitë, që gjoja bëjnë sikur konkurrojnë ndërmjet tyre në merkaton e votës, ndajnë tanxhentet në bazë të peshës elektorale, që kanë efektivisht, në mënyrë që të ruajnë të njëjtat raporte dhe të njëjtën peshë në pushtet.

Krijohet kështu një sistem pervers, në të cilin kush ka më shumë para përfiton më shumë funksione publike, sepse nëpërmjet parave, ia arrin të kontrollosh aparatet e partisë dhe për rrjedhojë, të formosh listat zgjedhore, kështu që duke fituar sa më shumë këshilltarë dhe sa më shumë funksione publike, më shumë para, më shumë të ardhura në një rreth vicioz lehtësisht të kuptueshëm. Në të gjithë këtë kontekst, janë ndeshur magjistratët, që më pas, në mënyrë paradoksale, janë gjendur të sulmuar egërsisht.

Më ka ndodhur të hetoj disa raste në të shkuarën për ngjarje të tjera dhe njëra prej tyre, ishte e ashtuquajtura “burgim i artë”; krijova idenë se bëhej fjalë për një situatë tepër të veçantë: një blerës i vetëm, sepse askush nuk mund të blejë burgje përveçse shteti. Në këtë rast, ishin disa funksionarë të departamentit rajonal të veprave publike që donin të paguheshin. Kurrë nuk do të kisha imagjinuar që sistemi i korrupsionit do të ishte i pranishëm edhe në situata të tilla dhe dukshëm të rregulluara nga merkatoja. Kur një ditë, arriti një menaxher që më tregoi se si funksiononin prokurimet për Anas-ën¹; tha se ishin rreth treqind biznese, të

¹ Azienda Nazionale Autonoma Delle Strade – Ndërmarrja Nazionale Autonome e Rrugëve (shënim i përkthyesit).

gjitha në unison, që ranë dakord të ndanin prokurimet me short. Njëra bënte ofertën për të fituar dhe të gjitha të tjerat formulonin oferta për të humbur. Edhe, nëse vinte dikush tjetër i jashtëm nga dakordësia, të gjithë së bashku do të bënin që me hir apo pa hir, ta nxirrnin jashtë loje. Për shembull, duke pranuar të punonte me humbje për një ose dy kontrata, në mënyrë që i ardhuri i ri të mbytej nga ana ekonomike, ose duke bërë oferta, të cilat nuk mund të pranoheshin, por edhe pse ishin oferta që nuk mund të pranoheshin, nëse ishte korrupsioni, rregulloheshin (në kuptimin që hyn në veprim rishikimi i çmimit, shkaktuar nga ndryshimet e varianteve të punës në proces; nëse në të kundërt, dikush nuk është i korruptuar, kërkohet respektim i përpiktë i rregullave të kontratës; edhe kontrollet që mund të jenë pak a shumë fiskale, mund të anashkalojnë gjithçka, ose mund të mos anashkalojnë asgjë).

Është shumë e rëndësishme të zbulohen këto mekanizma, sepse gjurmët e jashtme shfaqen kur krimet e prezumuara shuhën, si rrjedhojë e parashkrimit. Për shembull, kur një urë që ishte ndërtuar keq (sepse askush nuk e ka kontrolluar) rrëzohet pas tridhjetë vjetësh, krimet e korrupsionit të kryera tridhjetë vjet më parë, tashmë janë parashkruar. Natyrisht, mund të hetohet e të procedohet për rrëzimin e ndërtimit, për vrasje, nëse mbi urë në këtë moment udhëtonin autovetura dhe, nëse fatkeqësisht dikush ka gjetur vdekjen, por nuk do të jetë më e mundur të rindërtohet që në fillësë e gjithë skema e kësaj veprimtarie kriminale.

Në çdo rast, të gjithë e kujtojnë furinë e zemëratës popullore, që shoqëroi hetimet e njëzet e pesë viteve më parë dhe mbase ishte ajo që kultivoi shpresën për një ndryshim rrënjësor të kursit. E megjithatë skandalet nuk do të mbaronin dhe akoma sot është dikush që të çudit: për të filluar nga mjetet e informimit. Vërehet një errësim, një mospërfillje, në fakt një trajtim si një efekt anësor i represionit penal mbi devijimin kriminal.

Kam folur për këtë në publik rreth njëzet vite më parë, në 1996-ën: në atë rast u qortova nga një anëtar i CSM-së¹, gjatë një seminari të organizuar pikërisht nga Këshilli i Lartë i Magjistraturës për një ballafaqim ndërmjet rendit gjyqësor italian dhe atij francez. Ishin gjashtëdhjetë e pesë magjistratë italianë dhe tridhjetë e pesë francezë dhe unë - që faktikisht nuk figuroja ndër relatorët. U thirra në podium për të shpjeguar atë që kishte ndodhur te ne vitet e fundit. Ndër të tjera, u shpjegova kolegëve francezë se çfarë kishte dalë nga hetimet, një shembje e madhe politike. Kishin dalë nga vitrina politike pesë parti, ndër të cilat ajo e maxhorancës relative. Dhe konkludova: “Ne, organet e ngarkuara për represionin penal, forcat e policisë dhe magjistratura zhvilluam respektivisht, ndaj devijimit kriminal, funksionet tipike që zhvillojnë në natyrë gjuetarët: vërtet përmirësuam një racë grabitqarësh. Por kapëm zebat e ngadalta, ndërsa

¹ CSM, Consiglio Superiore della Magistratura (shënim i përkthyesit).

ato më të shpejtat na mbetën pa u kapur. Nëse më lejoni, kemi krijuar qenie rezistente, si antibiotikët që krijojnë qeniet rezistente ndaj antibiotikëve”.

Anëtari i Këshillit të Lartë të Magistraturës u irritua dhe më pyeti nëse ishte me të vërtetë e nevojshme të thuheshin ato gjëra para kolegëve francezë, por unë qëndrova absolutisht në bindjen time, ashtu sikundër mbetem i bindur që në periudhën e gjatë të evolucionit të racës grabitqare, u përmirësuan edhe gjuetarët. Nga ana tjetër, në asnjë vend dhe në asnjë epokë, kriminaliteti nuk ka qenë kurrë tërësisht i nënshtruar, ndërsa ai i mbijetuari pësoi një presion selektiv.

Natyrisht, në Itali gjërat shkuan më keq se gjetkë, duke konsideruar që veprimtaria kryesore e politikës për më shumë se njëzet vjet nuk ishte ajo që do t’ia vështirësonte veprimtarinë krimeve të korrupsionit, por ajo që do t’ia bënte më të vështirë hetimeve dhe proceseve për këto krime.

Herë pas here, gjatë disa debateve, më vjen të them përsëri: “Keni bërë një lëmsh të tërë, keni proceduar pothuajse 4500 persona dhe sot vjedhin akoma më shumë se më parë”. Dua ta dramatizoj pak dhe të përgjigjem me një barsoletë. Gjatë periudhës fashiste, u promovua me të vërtetë një luftë kundër mizave dhe mushkonjave dhe kjo praktikë u çua më tej edhe në dhjetëvjeçarin e parë pas Luftës së Dytë Botërore.

Kur isha fëmijë, më kujtohet që komunat ngjaisnin afishe me shkrimet: “Luftë kundër mizave dhe mushkonjave”; çdo familje duhet të dezinfektonte

banesën e saj dhe komuna dezinfektonte mjediset publike me *ddt* (sot e dimë që ishte kancerogjen, por në atë kohë nuk njihej si i tillë). Ky është konteksti. Barsoleta është kjo: një prefekt shkon për vizitë në një komunë të vogël, ku pritet nga kryetari i saj, por menjëherë sapo zbret nga makina, sulmohet nga një tufë mizash. Atëherë, me një ton qortues, i drejtohet kryetarit dhe i thotë: “Ore, në këtë komunë nuk paskeni bërë luftë kundër mizave?”. Dhe kryetari i përgjigjet: “Po, shkëlqesi, por kanë fituar mizat!”.

Sidoqoftë, dua të them, se unë mbetem ende optimist.

Vite më parë më ka ndodhur të frekuentoj shpeshherë një noter, për të vërtetuar nënshkrimin në prokurat e posaçme në emër të përfaqësuesve të mi ligjorë për të ngritur padi civile në procese, në të cilat kam qenë i dëmtuar për veprat penale të shpifjes dhe fyerjes. Noteri, i zemëruar, duke parë frazat që kishin thënë ndaj kolegëve të mi dhe ndaj meje dhe duke imagjinuar tensionet që mund të shkaktonte një gjë e tillë, më pyet, që si është e mundur të vazhdonim punën kështu. Iu përgjigja: “Nuk më bëjnë të tërhiqem”. Noteri megjithatë m’u kundërvu, duke më thënë se një gjë e tillë, një qëndrim i tillë do të vlente vetëm për atë që do të kishte një formim kulturor të krishterë dhe që sipas *Talmud-it*¹, as të drejtët nuk

¹ Është një nga tekstet e shenjta të hebraizmit. Si traditë citohet me termin Shas, një shkurtim hebraik i *shisha sedarim*, “gjashtë urdhëresat”, referuar gjashtë urdhëresave të Mishnah (shënim i përkthyesit).

mund të fitojnë në këtë botë, përndryshe nuk do të ishte i nevojshëm shëlbimi.

Përballë kësaj thënieje të mençur, u përgjigja duke cituar edhe një herë dialogun ndërmjet Krishnës dhe Arjunës në *Mahabharata*, poemë epike indiane¹, që tregon luftën ndërmjet familjeve *Kaurava* dhe *Pandava*. Arjuna, protagonist, i shkatërruar nga kjo luftë, që nuk di më se çfarë duhet të bëjë, as se çfarë pasojash do të vijnë nga veprimet e tij të fundit, pyet se si duhet të sillet. Krishna i përgjigjet, se ai është një luftëtar dhe se detyra e tij është të luftojë pavarësisht nga pasojat përfundimtare. Nuk është detyra jote, por e zotave të drejtojnë botën, ti duhet të bësh vetëm më të mirën e aftësive të tua, atë që të ka rënë për pjesë të bësh.

Jam i bindur, që secili nga ne të kërkojë të bëjë më të mirën e aftësive të tij, atë që i ka rënë për detyrë të bëjë dhe bota do të jetë akoma më e mirë.

¹ E njohur si Kisnaveda, është një nga poemat epike më të mëdha indiane së bashku me Ramayana (shënim i përkthyesit).

III

Restaurimi

Në realitet, sistemi i vjetër politik shumë shpejt u rikompozua në forma të reja, duke vazhduar të shkelë si vullnetin e opinionit publik (për shembull duke anashkaluar rezultatin e referendumit për shfuqizimin e financimit publik të partive politike, që sot marrin më shumë para se më parë, me justifikimin e rimbursimit për shpenzimet elektorale), ashtu edhe nevojat, shpeshherë të imponuara për më tepër nga institucionet ndërkombëtare (Organizata e Kombeve të Bashkuara, Këshilli i Europës, Bashkimi Europian, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Organizata për Bashkëpunim e Sigurim Europian) për të rikthyer ligjshmërinë dhe transparencën ndaj institucioneve dhe tregut.

Që nga ajo kohë (dhe deri pak kohë më parë) është vënë re nisja e një tentative për restaurim që ka sjellë një rezultat të dyfishtë, uljen e dukshme të dënimeve për korrupsion dhe rënien për çdo vit të Italisë në indeksin e korrupsionit, të perceptuar deri në vendet e fundit (në kuptimin e të fundit në klasë) në botën perëndimore, prapa shumë vendeve afrikane e aziatike.

Në mesin e parë, por jo të dytë të viteve '90, pati një përpjekje për të rikuperuar vlerat etike e politike, që synonin transformimin e Italisë në një vend modern, të ngjashëm me ato vende që do të duhet të ngjante. Por më pas, në vitet e mëpasshme, asgjë nuk u bë (përveçse detyrat që rridhnin nga konventat ndërkombëtare), për ta bërë më të lehtë zbulimin dhe goditjen e veprave penale të korrupsionit, ose për ta bërë më të vështirë kryerjen e këtyre krimeve. Nga ana tjetër, përkundrazi, është bërë shumë për të penguar hetimet, proceset, dënimet. Dhe kjo, jo vetëm si rrjedhojë e një krahu të veçantë të politikës, por nga ana e pjesës më të madhe të të dy krahëve politikë që ekzistonin atë kohë. Dua të shtoj, se qendra e djathtë tentoi disa herë të kalojë dispozita të tilla anormale, që për fat nuk mundi t'i kalojë. Qendra e majtë promovoi veprime shumë më efektive dhe praktikisht ka qenë më nismëtare në këtë drejtim, duke tërhequr edhe votat e të tjerëve. Nga këndvështrimi i atyre që janë objekt i goditjes penale, është më mirë që gjithmonë të qeverisë qendra e djathtë!

Duhet të jetë e qartë, se në një sistem me korrupsion të përhapur dhe të ndërtuar mbi bazën e një sistemi kriminal, janë të këqijta ata që fitojnë më në fund. Ajo që politika italiane nuk kupton, është se në fund të fundit është ajo që do të nxirret jashtë loje nga një sistem që në kapilarët e tij rrjedh korrupsioni; nuk është se bën karrierë sepse je i pari apo më i miri, as mos t'ju shkojë ndër mend! Më në fund, rreziku është

se do të arrijë Koza Nostra¹ apo Ndrangheta² që do të komandojë. Është një rrugë vetëvrasëse për të gjithë.

Kur dalin në dritë elemente relativisht të rënda për një ngjarje - pak rëndësi ka nëse kjo ngjarje është me ose pa elemente me vlerë në aspektin penal - zakonisht shpërthen një mekanizëm kureshtar, që shtyn shumë komentatorë të konkludojnë me vrap: “Presim vendimet gjyqësore”. Por si, “Presim vendime gjyqësore?” Meqë ra fjala, detyrohem të përsëris një metaforë që përdoret shpesh: nëse ftoj për darkë komshiun tim dhe konstatoj se ai më merr një argjendurinë dhe e fut në xhep, nuk është se më duhet të pres vendimin e Gjykatës së Kasacionit, për të mos e ftuar më për darkë: menjëherë vendos që të mos e ftoj. Do të thosha edhe më shumë: nuk do ta ftoja më kurrë për darkë edhe nëse do të rezultonte i pafajshëm, sepse ishte një kleptomani dhe se nuk ishte më shumë qëllimi i tij të vidhte, sesa sëmundja e tij. Për mua nuk ka rëndësi asnjë rrethanë lehtësuese, pra nuk do ta ftoja kurrë! Në botën e ekonomisë dhe të politikës thuhet “presim vendimet”: dhe kjo - e nënvizoj - do të thotë t’ia atribuosh gjyqtarëve edhe detyrën e seleksionimit të klasës drejtuese. E pra, kjo nuk shkon.

Nëse sot ne procedojmë një ish, kohë më parë me funksione me përgjegjësi, një nga “të barabartët” e tij,

¹ Mafia siciliane (shënim i përkthyesit).

² Mafia kalabreze (shënim i përkthyesit).

sikundër ishte mësuar të thoshte një nga kryeministrat tanë, ajo që do të ndodhte në sallat tona të gjyqeve, do t'i ngjante dhe do të kishte të njëjtën pamje si një muze prej dylli: do të kishte një rëndësi thjesht historike, por asnjë ndikim mbi aktualitetin politiko-ekonomik. E megjithatë, e gjithë kjo pothuajse nuk ndodh kurrë. Nëse pastaj, vendimet janë me dënime, hapu qiell! Atëherë do të bëhej fjalë për një persekutim politik nga ana e gjyqtarëve e prokurorëve dhe, përsëri edhe më keq, askush nuk do të shqetësohej rreth fakteve që mbështesin akuzat dhe vendimin e gjykatës: do të diskutohej vetëm rreth ngjyrimin politik të togave...

Por në Itali kjo është një histori antike: mjafton të kujtohet figura e Aurelio Sansonit, magjistrat në Toskanë gjatë viteve '20. Sikundër kujtohet, ishte i pari gjyqtar i quajtur me përçmim "i kuq". Pra i politizuar dhe fraksionist, pa legjitimitet. "Në realitet nuk ishte as i kuq dhe as gri", ka shkruar Piero Kalamandrei (Piero Calamandrei), duke i dedikuar botimin e tretë të "Elozh gjyqtarëve shkruar nga një avokat"¹, "Aurelio Sansoni ishte thjesht një gjyqtar i drejtë: për këtë e quanin 'të kuq' (sepse gjithmonë, ndër shqetësimet që e prisnin një gjyqtar të drejtë, ishte edhe ajo e të gjendurit i akuzuar: kur nuk ishte i gatshëm në shërbim të një fraksioni, medoemos ishte në shërbim të fraksionit kundërshtar)".

¹ Libër i shkruar nga Piero Calamandrei. Botuar për herë të parë në vitin 1935. Përmban meditime të tij në marrëdhëniet gjyqtar-avokat (shënim i përkthyesit).

Supozoj se katekizmin e kishin mësuar të gjithë italianët, ashtu sikurse ma kishin mësuar edhe mua kur isha fëmijë. E po mirë, na është thënë se vlefshmëria e një shenjtërimi varet nga respektimi i normave liturgjike dhe jo nga fakti se ministri i kultit është i denjë; nëse prifti thotë meshën ashtu sikundër e përshkruan meshari roman dhe konsakron Eukaristinë sipas kanuneve të vendosura, atëherë bashkimi vlen edhe nëse prifti ka një të dashur! Atëherë, nëse është kështu, përse diskutohet për ngjyrimin politik të magjistratit dhe jo rreth akteve që ai ka përpiluar? Këto akte, janë në përputhje me kërkesat e Kodit, po apo jo? Pas kësaj, magjistrati do të mendojë siç e sheh të arsyeshme!

IV

Serial dhe depërtues: si funksionon korrupsioni

Korrupsioni (duke përdorur terminologji joteknike, por gjithëpërfshirëse për mitën, trafikun e influencës e financimin e paligjshëm të partive dhe eksponentëve politikë) prezanton disa aspekte të veçanta: serialitetin dhe depërtueshmërinë.

Serialitetin, sepse bëhet fjalë për një krim me tendencë ripërsëritëse në pafundësi herësh. Një funksionar publik që shitet, pse do të duhet të shitet një herë të vetme? Është e qartë se ai do të priret të përsërisë të njëjtin veprim në të gjitha rastet që do t'i paraqiten, me bindje se nuk do të ndëshkohet; një kompani që ia beson zhvillimin e saj jo aftësive të shëndosha menaxhuese, por lidhjeve të privilegjuara dhe të paligjshme, do të vazhdojë të ndjekë pikërisht këtë rrugë. Depërtues ose shpërndarës është gjithashtu, sepse shfaqet fenomeni ku një i korruptuar pasohet shpejt ose vonë me të tjerë, për aq kohë sa do të jenë njerëzit e ndershëm që do të lihen mënjanë.

Nga ana tjetër, korrupsioni është një krim me *shifra të zeza* (diferenca ndërmjet krimeve të kryera dhe atyre që efektivisht kanë dijeni autoritetet)

mjaft të larta: zakonisht, korrupsioni është i njohur vetëm nga korruptuesit, sekserët apo ndërmjetësit dhe të korruptuarit, të cilët kanë të gjithë një përkim interesash për të ruajtur heshtjen. Si rregull, nuk ndodh para dëshmitarëve, është një krim me të dëmtuar të shpërndarë, domethënë nuk ka një individ fizik që e percepton menjëherë dëmin e pësuar dhe që të mund të reagojë dhe të kallëzojë menjëherë: është një diçka që dëmton shumë, por në një mënyrë të tillë që askush nuk e percepton drejtpërdrejt se ka mbetur viktimë.

Të dhënat statistikore gjyqësore janë thelbësisht të pabesueshme dhe vetë deklarimi i INSTAT-it për krimet e “denoncuara” është i pasaktë: nuk bëhet fjalë pikërisht për krimet e denoncuara, por për krime të hedhura në regjistrat përkatës, që është një gjë krejtësisht e ndryshme, mbasi këto krime të regjistruara janë kryesisht ato që janë përftuar si rrjedhojë e gjykimeve nga vetë autoriteti gjyqësor.

Një karakteristikë tjetër e vendit tonë, është se te ne nuk ekzistojnë trupat e policisë gjyqësore. Policia italiane ka trupa që janë njëkohësisht edhe për sigurinë publike, edhe si polici gjyqësor. Kjo do të thotë, se ato janë të organizuara mbi të gjitha për të goditur të ashtuquajturat “krime të dukshme”, domethënë ato që prekin menjëherë rendin publik. Pra, me vëmendje të veçantë ndaj krimit të zakonshëm, edhe pse ndër vite është përsëritur që problemi kryesor i vendit tonë është siguria. Në të kundërt, korrupsioni është shumë më serioz dhe hyn në devijimin e të ashtuquajturave “jaka të bardha”.

Një shembull që tregon seriozitetin e fenomenit: në procesin “Parmalat”¹, ndodhur rreth dhjetë vjet pas ngjarjeve ndaj të cilave morën nisjen pikërisht këto refleksione, ishin rreth 45 000 padi civile në procesin penal, apo 45 000 të dëmtuar që kërkonin shpërblimin e dëmeve. Nëse gjyqtari do të pranonte kërkesat e të gjithëve, ai kurrë nuk do të mbaronte tërësisht gjykimin, sepse do t’i duhej të merrej vetëm me paditë civile! Për fat, shumë avokatë përfaqësonin jo një, por disa të dëmtuar, gjë që bëri që të procedohej shumë më shpejt. E pra, ky rast ilustron shumë mirë pafundësinë e fenomenit. Sa kohë duhet që një hajdut të shënjojë 45 000 viktima? Dhe jo vetëm: në shumë vite në magistraturë, nuk më ka ndodhur kurrë të takoj dikë që në çantën e vjedhur të ruante kursimet e një jete; e pra shumica e këtyre që kishin bërë padi civile, kishin investuar në bondet e “Parmalatit” të gjitha kursimet e tyre. Të kuptohemi, nuk kam asnjë lloj simpatie për hajdutët. E megjithatë, kjo na jep një ide lidhur me rëndësinë për sa i përket ndryshimit të të dyja llojeve të krimeve për të cilat po flasim. Për fat të keq, strukturat janë të pajisura e të përgatitura për

¹ Ishte ndër skandalet më të mëdha të falimentit që ka ndodhur ndonjëherë për një institut krediti privat në Europë - shoqëria “Parmalat”, me pronar Calisto Tanzi, njëherësh edhe pronar i Klubit të futbollit “Parma”. Bëhej fjalë për kontabilitet të rremë, falsitet në bilanc, shpërdorime, vjedhje, etj., duke krijuar një “gropë të zezë”, të vlerësuar rreth shtatë miliard euro, për të cilën u dënuan pronari me tetëmbëdhjetë vjet burgim, por edhe menaxherë, auditorë, kryetar bashkish etj. (shënim i përkthyesit).

të shtypur mikrokrimin e zakonshëm dhe jo kriminalitetin e “jakave të bardha”.

Në thelb, të korruptuarit janë një pakicë e informuar kundër shumicës së qytetarëve të painformuar sepse janë të përjashtuar nga njohja e mekanizmave, njerëzve dhe fakteve. Të korruptuarit dhe korruptuesit nuk prezantohen - të paktën zakonisht - në cilësinë e tyre të vërtetë, por reklamohen të ndershëm dhe, në raste të rralla, kur individualizohen, përpiqen të bëjnë viktimën e persekucionit gjyqësor, politik apo të shpifjeve.

Nga ana tjetër, nuk jemi përballë një devijimi individual, por mbi të gjitha, para një sistemi kriminal, ekzaktësisht i barabartë me atë të krimit të organizuar. Ka një sistem të tij të sanksioneve, që mbase nuk është aq i egër sa ai i krimit të organizuar: si rregull nuk qëllon, por e përjashton subjektin e konsideruar si jo të besueshëm nga kontratat apo prokurimet e mëtejshme dhe e mban atë jashtë rrethit të informacioneve të rezervuara.

Ky aspekt shpjegon se përse më tej krijohen reaksione zinxhir. Në vitin 1992, shumë biznesmenë, që deri atëherë kishin marrë pjesë në kartele korruptive, “të zbuluar” e të lodhur nga zhvatjet, në vend që të bashkonin forcat me të korruptuarit, filluan të “shkarkoheshin”, duke i siguruar hetuesve listat e ryshfeteve që kishin paguar. Në fillim, kryesitë e partive u distancuan nga subjektet që u arrestuan, duke i përshkruar si individë të izoluar, mollë të veçanta të kalbura. Dhe këta, që u ndien të braktisur nga